



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 7

Tiranë – E hënë, 10 mars 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 1416/1, datë 7.3.2025	Për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.....	3
Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 156/4, datë 7.3.2025	Për procedurën konkurruese për kontratën me objekt “Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i LIFT Tower”.....	3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 8, datë 7.3.2025	Për shprehje interesi për shërbimin “Furnizimi për Spitalin e Krujës, loti 6, ‘Mobilie’”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	7

**KËRKESË****Nr. 1416/1, datë 7.3.2025**

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
KANDIDATËT QË KËRKOJNË TË
CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe në urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkangjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;
2. Kopje të mjetit të identifikimit;
3. Certifikatë familjare;
4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë, ose diplomë të lëshuar nga institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;
6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;
8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjobë ose masë administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar,

praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme;

10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

NJOFTIM**Nr. 156/4, datë 7.3.2025**

**PËR PROCEDURËN KONKURRUESE
PËR KONTRATËN ME OBJEKT
“ZHVILLIMI NËPËRMJET
SIPËRMARRJES I LIFT TOWER”**

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit:	Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore
Nënprojekti:	Ndërtimi dhe menaxhimi i godinës së Kadastrës Shqiptare
Titulli i kontratës:	Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i LIFT Tower

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata zhvillon projektin e investimit “Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore”, pjesë e të cilit është nënprojekti “Ndërtimi dhe menaxhimi i godinës së Kadastrës Shqiptare”, nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes lidhur me dy prona shtetërore, prona për zhvillim me sipërmarrje dhe prona për zhvillim publik, të përcaktuara në seksionin IV, nënseksioni 2, “Informacioni për pronën”, të “Dokumentit të kualifikimit”.

3. Projekti i investimit synon të transformojë hapësirat dhe godinat e vjetra shtetërore që shfaqin aktualisht shenja amortizimi, degradimi dhe infrastrukturë të vjetruar, jobashkëkohore dhe ku kushtet ekzistuese tregojnë nevojën për të përmirësuar cilësinë e pronave. Interesi publik që



përndjek projekti i investimit konsiston në përmirësimin e kushteve të punës së funksionarëve publikë, si dhe në energjizimin e qytetit, duke sjellë zhvillimin e zonave urbane ku ndodhen pronat. Projekti realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit dhe të ndërmjetësuesit midis institucionit publik që ka interes të zhvillojë pronat e tij dhe të përfitojë godina bashkëkohore dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe kapacitetet ekzekutive dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit.

4. Partneri privat siguron përfitueshmëri të investimit të kryer, duke shmangur çdo burokraci dhe paqartësi në lidhje me statusin e pronës (pronë shtetërore e certifikuar), në marrjen e lejeve (Korporata ka aplikuar për marrjen e lejes së zhvillimit nga KKT-ja mbi projektidetë arkitekturore të dy objekteve), si dhe në çdo marrëdhënie me autoritetet publike, por ai, gjithashtu, në bashkëpunim me Korporatën ndihmojnë në realizimin e qëllimit publik të këtij projekti investimi.

5. Korporata, nëpërmjet kësaj procedure konkurruese publike ndërkombëtare, synon të përzgjedhë partnerin privat, në cilësinë e sipërmarrësit për zhvillimin e pronës për sipërmarrje, duke realizuar projektidenë arkitekturore të bashkimi të subjekteve Baukuh Studio Associato & Muoto & Sam Chermayeff Office & Yellow Office & Bollinger Grohmann & Atmoslab & Simoj Boudvin & Arkimade.

6. Subjektet që do të hartojnë projektet e detajuara arkitektonike janë përzgjedhur me një konkurs projektimi dhe njihen si “Nënkontraktorë të emëruar” nga Korporata, në përputhje me përcaktimet për “Nënkontraktorët e emëruar” në “Udhëzimet për aplikantët” në “Dokumentin e kualifikimit”. “Nënkontraktorët e emëruar” për nënprojektin “Ndërtimi dhe menaxhimi i godinës së Kadastrës Shqiptare” jepen në seksionin IV, nënseksioni 4, “Nënkontraktorët e emëruar”, të “Dokumentit të kualifikimit”.

7. Procedura e konkurrimit për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse konkurruese me zarf, me dy faza, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në “Rregulloren e procedurave konkurruese”, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës [link](#). Procedura

është e hapur për të gjitha subjektet persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendas apo të huaj.

8. Ky “Njoftim i procedurës konkurruese” hap fazën e parë të konkurrimit për përzgjedhjen e Partnerit Privat. Kualifikohen në këtë procedurë konkurrimi aplikantët, të cilët plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe marrin përsipër angazhimet e përcaktuara në “Dokumentin e kualifikimit”. “Dokumenti i kualifikimit” hartohet në gjuhët shqip dhe anglisht dhe publikohet në faqen e internetit të Korporatës [link](#).

9. Në fazën e parë, kandidatët, përveç plotësimit të kriterëve të kualifikimit, duhet të marrin përsipër përmbushjen e angazhimeve/kushteve, si më poshtë:

a) angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projektit më të mirë të zhvillimit të pronës (vlëra jepet nga Korporata sipas kërkesës);

b) angazhimin për pagesën e vlerës së hartimit të projektit të detajuar arkitektonik, bazuar në projektidenë arkitekturore fituese të konkursit, e cila nuk mund të jetë më shumë se vlëra e deklaruar nga projektuesi (vlëra jepet nga Korporata sipas kërkesës);

c) angazhimin për sistemimin në ambiente pune të përshtatshme, të punonjësve të institucioneve publike, që aktualisht punojnë në pronat objekt i këtij projekti investimi, për të gjithë periudhën e ndërtimit, deri në dorëzimin e pronës për zhvillim publik (nevojat e institucioneve jepen nga Korporata sipas kërkesës; përshtatshmëria e ambienteve do të negociohet me Korporatën);

d) angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;

e) angazhimin për regjistrimin e pronës së re dhe kalimin e pjesëve takuese të Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;

f) angazhimin se në pronën për sipërmarrje dhe në pronën për zhvillim publik do zhvillohen projektidetë arkitekturore sipas lejes së zhvillimit;

g) angazhimin e lidhjes së kontratës me “Nënkontraktorët e emëruar” nga Korporata, për detajimin e projektidesë arkitekturore, sipas projektidesë arkitekturore të miratuar me lejen e zhvillimit;



h) angazhimin që me kërkesë të Korporatës nga pjesa takuese e Korporatës në ndërtesën LIFT Tower, të zhvillohet plotësisht projektidea arkitekturore e godinës së Kadastrës Shqiptare në pronën për zhvillim publik, sipas lejes së zhvillimit;

i) angazhimi për të lidhur me Korporatën kontratën e sipërmarrjes dhe marrëveshjeve shoqëruese të saj, në përfundim të procesit të përzgjedhjes dhe mbulimin e shpenzimeve të lidhjes së saj (vlëra jepet nga Korporata sipas kërkesës).

Këto angazhime përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes, mospërmbushja e të cilave sjell pavlefshmërinë e kontratës.

10. Faza e dytë e konkurrimit do t'u njoftohet vetëm kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë nëpërmjet dërgimit të "Ftesës për ofertë". Ofertat e paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është **45% (dyzet e pesë për qind)** dhe do të vlerësohen me kriterin përzgjedhës, i cili është:

a) përqindja më e lartë e sipërfaqes përkatëse e ofruar për Korporatën në ndërtesën LIFT Tower mbi kriterin bazë.

Shpallet fituese oferta që ofron vlerën më të lartë të kësaj përqindje.

11. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00, ora lokale.

12. Aplikimet mund të përgatiten dhe dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht duhet të përkthehen në njërin nga këto gjuhë.

13. Aplikimet mund të dorëzohen me *e-mail*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **17 prill 2025, ora 15:00, ora lokale**.

14. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme.

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al;

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

Notice of the Competition Procedure

Developer of Investment	Albanian Investment Corporation
Project:	
Name of Investment	Development and management of state buildings
Project:	Construction and management of the Albanian Cadastre building
Sub-project:	Development of LIFT Tower
Contract Title:	

1. The Albanian Investment Corporation, here "Corporate" is a joint-stock commercial company entirely owned by the state, with the Ministry responsible for the economy of the Republic of Albania as its sole shareholder.

2. The Corporation develops the investment project "Development and management of state buildings", part of which is the sub-project "Construction and management of the Albanian Cadastre building", through the legal instrument of enterprise related to two state properties, the property for development with enterprise and the property for public development, set out in Section IV, subsection 2, Property Information, of the Qualification Document.

3. The investment project aims to transform old state spaces and buildings that currently show signs of depreciation, degradation and outdated, non-contemporary infrastructure and where the existing conditions indicate the need to improve the quality of the properties. The public interest pursued by the investment project consists in improving the working conditions of public officials, as well as in energizing the city by bringing about the development of the urban areas where the properties are located. The project is realized through a partnership model, where the Corporation has the role of developer and mediator between the public institution that has an interest in developing its properties and benefiting from contemporary buildings and the private partner that possesses financial, human resources and executive capacities and has an interest in realizing investment project.

4. The private partner ensures the profitability of the investment made by avoiding any bureaucracy and uncertainty regarding the status of the property



(certified state property), in obtaining permits (the Corporation has applied for obtaining a development permit from the KKT on architectural project ideas both facilities), as well as in any relationship with public authorities, but he also in cooperation with the Corporation help to realize the public purpose of this investment project.

5. The Corporation through this international public competitive procedure intends to select the private partner, in the capacity of Entrepreneur for the development of the property through enterprise, realizing the architectural project-idea of the union of the subjects Baukuh Studio Associato & Muoto & Sam Chermayeff Office & Yellow Office & Bollinger Grohmann & Atmoslab & Simoj Boudvin & Arkimade.

6. The entities that will draft the detailed architectural designs have been selected through a design competition and are recognized as “Designated Subcontractors” by the Corporation in accordance with the definitions for “Designated Subcontractors” in the Instructions to Applicants in the Qualification Document. The “Designated Subcontractors” for the subproject “Construction and Management of the Albanian Cadastre Building” are given in Section IV, subsection 4, Designated Subcontractors, of the Qualification Document.

7. The competition procedure for the selection of the Private Partner will be carried out through the competitive selection procedure with envelope, with two stages, namely the qualification stage and the selection stage, as specified in the “Regulations for the Competition Procedure”, published on the official website of Corporation [link](#). The procedure is open to all subjects, natural or legal persons, private or public, domestic or foreign.

8. This Notice of the Competitive Procedure opens the first stage of the competition for the selection of the Private Partner. Applicants who meet the qualification criteria and undertake the commitments defined in the “Qualification Document” are qualified in this competition procedure. The “Qualification Document” is drawn up in Albanian and English and published on the Corporation’s website [link](#).

9. In the first phase, qualified candidates, in addition to meeting the qualification criteria, must commit to fulfilling the following commitments:

a) the commitment to pay the costs of the international competition for the selection of the best property development project (the value is provided by the Corporation upon request);

b) the commitment to pay the costs of preparing the detailed architectural project based on the winning architectural project idea of the competition, which cannot be more than the costs declared by the designer (the value is provided by the Corporation upon request);

c) the commitment to make arrangements for the placement of employees of public institutions who currently work in the properties that are the object of this investment project, for the entire construction period, until the delivery of the property for public development (the needs of the institutions are provided by the Corporation upon request; the suitability of the premises will be negotiated with the Corporation);

d) the commitment to pay taxes, fees and contributions, in the context of the application for a development permit, construction permit, supervision of works or any stage of property development until the registration of the developed property;

e) the commitment for the registration of the new property and the transfer of the respective parts of the Corporation at the expense of the private partner;

f) the commitment that the architectural project ideas will be developed in the property for entrepreneurship and in the property for public development according to the development permit;

g) the commitment to conclude a contract with the Corporation’s “Nominated Subcontractors”, for the detailing of the architectural design, according to the architectural design approved with the development permit;

h) the commitment that at the request of the Corporation from the respective part of the Corporation in the LIFT Tower building, the architectural project idea of the Albanian Cadastre building will be fully developed in the property for public development, according to the development permit;

i) the commitment to conclude the development contract and its associated agreements with the Corporation, at the end of the selection process and covering the expenses to enter the contract (the value is provided by the Corporation upon request).



These commitments constitute the preliminary conditions of the business contract, the non-fulfillment of which leads to the invalidity of the contract.

10. The second phase of the competition will be announced only to the candidates qualified in the first phase through the Invitation to Offer. The offers submitted by the candidates in this phase must meet the basic criterion, which is **45% (forty-five percent)** and will be evaluated with the selection criterion, which is:

a) the highest percentage of the relevant area offered to the Corporation in the LIFT Tower building over the basic criterion.

The offer that offers the highest percentage is declared the winner.

11. Interested parties may obtain further information from the Corporation at the address provided below during business days between 09:00 and 17:00, local time.

12. Applications can be prepared and submitted in Albanian or English. Any accompanying documents that are in languages other than Albanian or English must be translated into one of these languages.

13. Applications may be delivered by e-mail by hand or by post to the address below **not later than April 17, 2025, at 15:00 local time.**

14. The opening of applications will take place immediately after the submission deadline at the following address:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova” 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al;

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

KËRKESË

Nr. 8, datë 7.3.2025

PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN “FURNIZIMI PËR SPITALIN E KRUIJËS, LOTI 6, ‘MOBILIE’”, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Datë 10 mars 2025

(Procesi i ofertimit me një zarf)

Shteti: Shqipëri

Emri i Projektit: Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (financim shtesë)

Titulli i kontratës: Furnizimi për Spitalin e Krujës, loti 6 “Mobilie”

Nr. i huas: IBRD-93060

Numri i referencës RFB: AL-MH-465587-GO-RFB

1. Qeveria e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore për koston e projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (financim shtesë) dhe synon të aplikojë një pjesë të të ardhurave për pagesat, sipas kontratës për furnizimin për Spitalin e Krujës: AL-MH-465587-GO-RFB 6 “Mobilie”.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale fton tani ofertat e vulosura nga ofertuesit e kualifikuar për Furnizim për Spitalin e Krujës: AL-MH-465587-GO-RFB, loti 6 “Mobilie”.

3. Kontrata pritet të përfundojë brenda maksimumit 60 ditë kalendarike. Procesi i tenderimit është i hapur për të gjithë ofertuesit që plotësojnë kriteret e mëposhtme të kualifikimit (më shumë informacion specifik mund të gjeni në dokumentet e tenderit për këtë procedurë).

Kapacitete financiare: Ofertuesi duhet të demonstrojë, për çdo lot, një qarkullim vjetor në shumën minimale të dhënë në një nga tre vjetët e fundit (2020, 2021, 2022): 28 000 euro – loti 6 “Mobilie”.

Ofertuesi duhet të dorëzojë pasqyrat financiare të audituara ose, nëse nuk kërkohet nga ligji i vendit të ofertuesit, pasqyra të tjera financiare të pranueshme për blerësin, për 3 [tre vjetët] e fundit (2020, 2021, 2022), duke demonstruar qëndrueshmërinë aktuale të pozicionit financiar të ofertuesit. Nëse ofertuesi merr pjesë në më shumë se një lot, ofertuesi duhet



të demonstrojë një shumë të xhiros mesatare vjetore gjatë tre vjetëve të fundit të barabartë me shumën e shumave minimale mesatare vjetore të qarkullimit të të gjitha loteve (të detajuara më sipër për secilin lot) për të cilin ai, unë, kam paraqitur oferta. Për një sipërmarrje të përbashkët, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga secili anëtar.

b) Përvojë specifike: Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka përfunduar me sukses të paktën 3 [tre] kontrata, brenda 3 vjetëve të fundit [tre vjetëve] (për çdo lot) përpara afatit të dorëzimit të ofertës. Të paktën një nga kontratat (të secilit lot) me vlerë prej 11,271 eurosh – loti 6 “Mobilie”.

Kontratat janë përfunduar me sukses dhe në mënyrë thelbësore dhe duhet të jenë të ngjashme në natyrë dhe në kompleksitet me mallrat dhe shërbimet e përafërta sipas kontratës. Për një sipërmarrje të përbashkët, kjo kërkesë mund të plotësohet nga të gjithë anëtarët së bashku. Kopjet e këtyre kontratave duhet të dorëzohen nga ofertuesi si dëshmi e kësaj kërkesë së bashku me faturat (kur kontrata nënshkruhet me subjekte private) ose letër referimi (kur kontrata është nënshkruar me entet publike).

ii. Dëshmia dokumentare: Ofertuesi që paraqet ofertat e tij për lotin 6 duhet të sigurojë prova dokumentare për të demonstruar se mallrat që ofron plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

i. Listën e kontratave kryesore të furnizimit të kryera brenda tre vjetëve të fundit, duke ofruar informacion të detajuar në lidhje me emrin e klientit, pikat e kontaktit, adresat e kontaktit, emrin e pajisjeve të mobiluara, shumën e kontratës, fillimin e kontratës dhe datën e përfundimit.

ii. Të paktën një letër referimi, e lëshuar nga ndonjë prej kontraktorëve (të tre vjetëve të fundit) për përfundimin me sukses të një kontrate të ngjashme me mallrat e mbuluara nga ky “Dokument tenderi”.

iii. Ofertuesi duhet të dorëzojë deklaratën e origjinës dhe të kompanisë prodhuese. Certifikata origjinale e origjinës (nëse nuk është e prodhuar në vend) duhet të dorëzohet gjatë dorëzimit të mallrave.

iv. Deklaratë se pajisjet e ofruara janë të reja dhe të prodhuara jo përpara vitit 2023.

v. Ofertuesi (nëse ofertuesi është prodhuesi i mobilieve) duhet të ketë të paktën një inxhinier dhe tre personel teknik. Duhet të jetë një inxhinier i specializuar për prodhimin e mobilieve prej druri.

Duhet të sigurohen CV-të origjinale, të nënshkruara nga vetë inxhinierët; ofertuesi duhet të sigurojë diplomën.

vi. Për qëllime të mirëmbajtjes pas garancisë, ofertuesi duhet të paraqesë listën e pjesëve/mallrave të këmbimit të lidhura me çmimet përkatëse (përfshirë koston e mirëmbajtjes) për secilën prej tyre. Këto çmime duhet të fiksohen për të paktën 7 (shtatë) vjet pas periudhës së garancisë së mallrave. Në këtë linjë, ofertuesi duhet të sigurojë një “deklaratë disponueshmërie shtatëvjeçare” për pjesët rezervë/materialet harxhuese dhe një “deklaratë disponueshmërie të stafit” për qëllimin e mirëmbajtjes për një periudhë të tillë.

vii. Certifikatat e mëposhtme ISO duhet të sigurohen për prodhuesin e mobilieve të ofruara:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalent “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme);

2. ISO 14001:2015 ose ekuivalent duke përfshirë lejen mjedisore, “Për sistemin e menaxhimit mjedisor” (e vlefshme);

3. ISO 45001:2018 ose ekuivalent “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (e vlefshme);

Nëse ofertuesi nuk është prodhuesi, ofertuesi duhet të sigurojë certifikatat ISO të mësipërme për prodhuesin dhe ISO 9001:2015 të tij ose ekuivalentin “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme);

4. Ofertuesi duhet të dorëzojë certifikatat e konformitetit për artikujt.

viii. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës ai merr përsipër të kryejë dorëzimin dhe montimin e mallrave që janë objekt i lotit 6.

d) Përvoja e prodhimit dhe kapaciteti teknik: Për artikujt sipas kontratës që ofertuesi është prodhues, ofertuesi duhet të sigurojë prova dokumentare për të demonstruar, se:

- Është regjistruar dhe licencuar nga autoriteti rregullator në vendin e prodhimit për furnizimin e mallrave;

- Ka prodhuar mallra të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm për të paktën 3 vjet [tre vjet], përpara afatit të dorëzimit të ofertave (duhet të jepet një deklaratë e kapacitetit të instaluar prodhues); dhe

- Kapaciteti i tij vjetor i prodhimit të mallrave të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm për secilin nga 3 vjetët e fundit [tre vjetët] përpara afatit të dorëzimit të ofertës, është të paktën 10 herë më



shumë se sasitë e specifikuara në kontratë (duhet të jepet një deklaratë e kapacitetit të instaluar prodhues).

e) Autorizimi i prodhuesit: Një ofertuesi që nuk prodhon një/arti/ar i kërkohet të sigurojë një autorizim prodhuesi në përputhje me BDS ITB 17.2 (a). Ofertuesi duhet të sigurojë dëshmi se është i autorizuar, siç duhet nga një prodhues (“Formulari i autorizimit të prodhuesit”, seksioni IV, “Format e ofertimit”), duke përmbushur kriteret në (d) (i) dhe (ii) më sipër, për të furnizuar mallrat:

i. duhet të jepet një deklaratë e kapacitetit të instaluar prodhues që deklaron se prodhuesi ka prodhuar mallra të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm për të paktën 3 vjet [tre vjet], përpara afatit të dorëzimit të ofertës;

ii. duhet të jepet një deklaratë e kapacitetit prodhues të instaluar, duke deklaruar se kapaciteti vjetor i prodhimit të prodhuesit të mallrave të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm për secilin nga 3 vjetët [tre vjetët] e fundit përpara afatit të dorëzimit të ofertës, është të paktën 10 herë sasitë e përcaktuara në kontratë.

Në momentin e dhënies së kontratës, ofertuesi (duke përfshirë çdo nënkontraktor të propozuar nga ofertuesi) nuk do t’i nënshtrohet skualifikimit nga Banka për mospërmbushje të detyrimit të SEA/SH.

Informacion më të detajuar dhe dispozitë më specifike mbi kriteret e kualifikimit të përmbushjes dhe dokumentet përkatëse, që do të dorëzohen mund të gjenden në “Dokumentet e tenderit”.

Ofertimi do të kryhet nëpërmjet prokurimit konkurrues ndërkombëtar, duke përdorur një “Kërkesë për oferta” (RFB) siç specifikohet në “Rregulloret e prokurimit për huamarrësit IPF” të Bankës Botërore, korrik 2016, i Bankës Botërore, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018 (Rregulloret e Prokurimit) dhe është e hapur për të gjithë ofertuesit, siç përcaktohet në Rregulloren e Prokurimit.

Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 (të premten).

Dokumenti i tenderit në gjuhën angleze mund të blihet nga ofertuesit e interesuar të kualifikuar me paraqitjen e një aplikimi me shkrim në adresën e mëposhtme dhe me pagesën e një tarife të

pakthyeshme prej 20,000 lekësh shqiptare. Mënyra e pagesës do të jetë me transfertë bankare. Dokumenti do të dërgohet me *e-mail*. Ofertuesit e interesuar janë të lutur t’i dërgojnë Njesisë së Koordinimit të Projektit (PCU) një *e-mail* ose letër për të regjistruar interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi së bashku me vërtetimin e pagesës. Një grup i plotë i dokumenteve të tenderit do të dërgohet pas marrjes së aplikacionit me shkrim ose me *e-mail*, së bashku me transaksionin bankar.

Kërkesa për dokumentet e tenderit duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

Në vëmendje: Znj. Blerina Dudushi – Menaxhere e Projektit të PCU-së

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Shqipëri

Adresa: Rruga e Kavajës; qyteti: Tiranë, Kodi Postar: 1000

Shteti: Shqipëri

Adresa e postës elektronike:

hsip.dudushi@gmail.com

Detajet bankare për pagesën e shumës 20,000 lekë shqiptarë

Emri i projektit:	FINANCIMI SHITESË PËR PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT SHËNDETËSOR
Emri i bankës:	CREDINS
Numri i llogarisë (lek shqiptar)	00002021762
IBAN: (lek shqiptar)	AL04212110090000000002021762

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme **deri më datë 25 prill 2025, ora: 09:00 me orën lokale**. Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen publikisht në prani të përfaqësuesve të caktuar të ofertuesve dhe kujtdo që zgjedh të marrë pjesë në adresën më poshtë

Për qëllime të dorëzimit të ofertave vetëm, adresa e punëdhënësit është:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Rruga e Kavajës – Tiranë, Shqipëri

Qyteti: Tiranë

Kodi ZIP: 1000

Shteti: Shqipëri

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është:

Data 25 prill 2025

Ora: 09:00



Hapja do të bëhet:

Data 25 prill 2025

Ora: 09:15

4. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen nga një garanci e ofertës, siç kërkohet në dokumentet e tenderit. Sigurimi i ofertës do të jetë i vlefshëm për 28 (njëzet e tetë) ditë përtej datës origjinale të skadimit të vlefshmërisë së ofertës, ose përtej çdo date të zgjatur, nëse kërkohet sipas ITB 18.2.

5. I është tërhequr vëmendja Rregulloreve të Prokurimit, që kërkojnë që Huamarrësi të japë informacion mbi pronësinë përfituese të ofertuesit të suksesshëm, si pjesë e njoftimit për dhënien e kontratës, duke përdorur “Formularin e zbulimit të pronësisë përfituese”, siç përfshihet në dokumentin e tenderit.

6. Adresat e përmendura më sipër janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vëmendje ndaj. Entela Ramosaçaj (Zëvendësministre)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Rruga e Kavajës – Tiranë, Shqipëri

Qyteti: **Tiranë**

Kodi ZIP: **1000**

Shteti: **Shqipëri**

Specific Procurement Notice

Dated 10 March 2025

Request for Bids

(One-Envelope Bidding Process)

Country: *Albania*

Name of Project: *Health System Improvement Project (Additional Financing)*

Contract Title: *Supply for Kruja Hospital Lot 6 Furniture*

Loan No: *IBRD-93060*

RFB Reference No: *AL-MH-465587-GO-RFB*

1. The Government of Albania has received a financing from the World Bank toward the cost of the health System Improvement project (Additional Financing), and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Supply for Kruja Hospital AL-MH-465587-GO-RFB Lot 6 Furniture

2. The Ministry of Health and Social Protection now invites sealed Bids from eligible Bidders for

Supply for Kruja Hospital AL-MH-465587-GO-RFB Lot 6 Furniture

3. The contract is expected to be completed within maximum 60 calendar days. The bidding process is opened to all the Bidders that fulfill the following qualification criteria: (more specific information may be found in the Bidding documents for this procedure).

Financial Capability: The Bidder should demonstrate, an annual turnover at the given minimum amount in one of the last three years (2020,2021,2022): *28, 000 Euro - Lot 6 Furniture*. The Bidder shall submit audited financial statements or, if not required by the law of the Bidder's country, other financial statements acceptable to the Purchaser, for the last 3 [three years] years (2020, 2021, 2022), demonstrating the current soundness of the Bidder's financial position. If the Bidder participates in more than one lot, the Bidder shall demonstrate an amount of the average annual turnover during the last three years equal to the sum of the minimum average annual turnover amounts of all lots (detailed above for each Lot) for which it has submitted bids. For a joint venture, this requirement shall be met by each member.

b) Specific Experience: The Bidder shall demonstrate that it has successfully completed at least 3 [three] contracts, within the last 3 years [three years] (for each Lot) prior to bid submission deadline. At least one of the contracts (of each Lot) with a value of *11,271 Euro - Lot 6 Furniture*

The contracts have been successfully and substantially completed and should be similar in nature and complexity to the Goods and Related Services under the Contract. For a joint venture, this requirement may be met by all members combined. Copies of these contracts should be submitted by the Bidder as a proof of this requirement along with the invoices (when contract is signed with private entities) or reference letter (when the contract is signed with public entity).

ii) Documentary Evidence: The Bidder submitting their bids for Lot 6 shall furnish documentary evidence to demonstrate that the goods it offers meet the following requirement:

i. List of major supply contracts conducted within the last three years, providing detailed information regarding the name of the client, focal points, contact addresses, name of the devices furnished, contract amount, contract starting and



completion date.

ii. At least one letter of reference, issued from any of the contractors (of the last three years) for successfully completion of a similar contract with the goods covered by this Bidding Document.

iii. The bidder must submit a declaration of origin and manufacturing company. Original Certificate of Origin (if it is not locally produced) should be submitted during the delivery of the goods.

iv. Declaration that the equipment offered are new and produced not before 2023.

v. The bidder (*If the Bidder is the manufacturer of the furniture*) must have at least one engineer and three technical staff. It must be an engineer specialized for wood furniture production. Original CV-s, signed by engineers themselves, is a must to be provided; The Bidder should provide the Diploma.

vi. For the purpose of the post-warranty maintenance, the bidder must submit the list of the spare parts/ consumables associated with respective prices (including maintenance cost) for each of them. These prices should be fixed for at least 7 (seven) years after the warranty period of the goods. In this line, the bidder, should provide a “seven years’availability declaration” for the spare parts/consumables, and a “staff availability declaration” for the maintenance purpose for a such period.

vii. The following ISO certificates should be provided for the manufacturer of the furniture’s offered:

1. ISO 9001:2015 or equivalent “For the Quality Management System” (valid);

2. ISO 14001:2015 or equivalent including Environmental Permit, “For the Environmental Management System” (valid);

3. ISO 45001:2018 or equivalent “For the Occupational Health and Safety Management System” (valid);

If the Bidder is not the Manufacturer, the Bidder should provided the above ISO certificates for the manufacturer and his ISO 9001:2015 or equivalent “For the Quality Management System” (valid);

4. The Bidder shall submit the certificates of conformity for the items.

viii. The Bidder must submit a declaration, by means of which he undertakes to carry out the delivery and assembly of the goods subject to lot 6.

d) Manufacturing experience and Technical Capacity: For the items under the Contract that the

bidder is a manufacturer, the Bidder shall furnish documentary evidence to demonstrate that:

- Has been registered and licensed by the regulatory authority in the country of manufacture to supply the Goods;

- It has manufactured goods of similar nature and complexity for at least 3 years [*three years*], prior to the bid submission deadline (a statement of installed manufacturing capacity should be provided); and

- Its annual production capacity of goods of similar nature and complexity for each of the last 3 years [*three years*] prior to the bid submission deadline, is at least 10 times the quantities specified under the contract (a statement of installed manufacturing capacity should be provided

e) Manufacturer’s authorization: A Bidder who does not manufacture an item/s is required to provide a manufacturer authorization in accordance with BDS ITB 17.2 (a). The Bidder shall provide evidence of being duly authorized by a manufacturer (Manufacturer’s Authorization Form, Section IV, Bidding Forms), meeting the criteria in (d) (i) and (ii) above, to supply the Goods:

i. a statement of installed manufacturing capacity should be provided declaring that the manufacturer has manufactured goods of similar nature and complexity for at least 3 years [*three years*], prior to the bid submission deadline.

ii. a statement of installed manufacturing capacity should be provided declaring that the manufacturer’s annual production capacity of goods of similar nature and complexity for each of the last 3 years [*three years*] prior to the bid submission deadline, is at least 10 times the quantities specified under the contract.

At the time of Contract Award, the Bidder (including each subcontractor proposed by the Bidder) shall not be subject to disqualification by the Bank for non-compliance with SEA/ SH obligation,

More detailed information and more specific provision on the fulfillment qualification criteria and the relevant documents to be submitted may be found in the Bidding Documents.

Bidding will be conducted through international competitive procurement using a Request for Bids (RFB) as specified in the World Bank’s “Procurement Regulations for IPF Borrowers” World Bank’s July 2016 Revised November 2017 and August 2018) (Procurement Regulations”) and



is open to all Bidders as defined in the Procurement Regulations. Interested eligible Bidders may obtain further information from Interested eligible Bidders may obtain further information from can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday:

The bidding document in English may be purchased by interested eligible Bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of 20,000 Albanian Lek. The method of payment will be through bank transfer. The document will be sent by email. Interested Bidders are requested to send to the project coordination Unit (PCU) an email or letter to register their interest to participate in this bidding procedure along with the proof of payment. A complete set of the bidding documents will be sent upon receipt of that written or email application along with the bank transaction. The request for Bidding documents must be submitted in the following address:

In attention to: Mrs. Blerina Dudushi – PCU Project Manager

Ministry of Health and Social Protection Albania

Address: Rruga e Kavajës, City: Tirana, ZIP Code: 1000

Country: Albania

Electronic mail address:

hsip.dudushi@gmail.com

Bank Details for payment of the amount of 20,000 Albanian Lek:

Project Name:	FINANCIMI SHITESË PËR PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT SHËNDETËSOR
Bank Name:	CREDINS
Account Number (Albanian Lek)	00002021762
IBAN: (Albanian Lek)	AL04212110090000000002021762

Bids must be delivered to the address below **on or before date 25 April 2025, Time: 09:00 AM local time**. Electronic Bidding will not be permitted. Late Bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the Bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend at the address below

For Bid submission purposes only, the Employer's address is:

Ministry of Health and Social Protection

Ministry of Health and Social protection, **Rruga e Kavajës – Tirana, Albania**

City: **Tirana**

ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

The deadline for Bid submission is:

Date 25 April 2025

Time: 09:00 AM

The opening shall take place:

Date 25 April 2025

Time: 09:15 AM

4. All Bids must be accompanied by a Bid Security as requested in bidding documents. The Bid Security shall be valid for 28 (twenty-eight) days beyond the original date of expiry of the Bid validity, or beyond any extended date if requested under ITB 18.2.

5. Attention is drawn to the Procurement Regulations requiring the Borrower to disclose information on the successful bidder's beneficial ownership, as part of the Contract Award Notice, using the Beneficial Ownership Disclosure Form as included in the bidding document.

6. The address(es) referred to above is (are):

Ministry of Health and Social Protection

In attention to. Mrs. Entela RAMOSAÇAJ (Deputy minister)

Ministry of Health and Social protection, **Rruga e Kavajës – Tirana Albania**

City: **Tirana**

ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

